



NEON A.S  
RR.XHANFISE KEKO, Nd.168 , H.1, CP. 1005  
TIRANA, ALBANIA  
TEL: +355 42 377 773 FAX: +355 42 347 770  
E-MAIL: [info@neon.al](mailto:info@neon.al) WEB: [www.neon.a](http://www.neon.a)

## NEON ORALAC PROFESSIONAL (BOJË ZMALTO PROFESIONALE)

Skedë Teknike

**PËRSHKRIMI:** NEON ORALAC PROFESSIONAL, është një bojë zmalto me bazë rezinë alkide, e cilësisë së lartë dhe me shkëlqim, e destinuar për lyerje të sipërfaqeve metalike, druri ose për mure në mjedise të brendshme apo të jashtme, me qëllim mbrojtje dhe dekoracion të konstruksioneve. Referuar përbërësve të saj, në kushte optimale të mjedisit boja thahet 4 - 6 orë pas aplikimit, duke krijuar një cipë me shkëlqim të lartë dhe rezistencë të kënaqshme mekanike që u reziston agjentëve të jashtëm atmosferik dhe ruan ngjyrën me kalimin e kohës.

**FUSHA E PËRDORIMIT:** NEON ORALAC PROFESSIONAL është i përdorshëm në mjedise të brendshme dhe të jashtme për bojatisjen e sipërfaqeve metalike, sipërfaqeve prej druri dhe mureve.

**NGJYRA:** Bojrat oralac janë të një game të madhe ngjyrash, të cilat jepen në katalogun e Kompanisë "NEON".

**PARAPËRGATITJA:** Sipërfaqja që do të bojatiset, duhet të pastrohet nga pluhurat, yndyrnat apo nga shtresa të mëparshme të bojës, të lidhura dobët me sipërfaqet.

**PËRDORIMI:** Përgatitet boja duke e holluar fillimisht me diluent NC – 10.00 ose NX – 20. 000 ose White Spirit "NEON" NW – 13.30 në sasi 10 % ÷ 20 %, për të përfutur një bojë të gatshme e cila të punohet relativisht lehtë me penel, rrul ose pistoletë dhe të mos rrjedhë në sipërfaqet vertikale.

**KUJDES:** Nuk lejohet aplikimi i bojës në sipërfaqe të njoma dhe dhe të pa pastruara papaparakisht. Gjatë aplikimit të përdoren doreza të përshtatshme pune për të evituar kontaktin e bojës me lëkurën, si dhe në rastin e përdorimit të pistoletës duhet përdorur maskë mbrojtëse për organet e frymëmarrjes. Në rast kontakti me sytë, duhet bërë shpërlarja e tyre me ujë të bollshëm dhe të kërkohet ndihmë mjeksore. Nuk rekomandohet përdorimi i bojës në temperaturë më të vogël se 5°C. Pas përfundimit të lyerjes paisjet duhet të lahen menjëherë me white spirit.

### TE DHENAT TEKNIKE:

- Ngjyra.....Sipas katalogut
- Imtësia.....5 – 40 µm
- Viskoziteti Deep Cup 4.....200 – 300 sek
- Densiteti.....0.94 – 1.35 g/ml
- Fuqia mbuluese për lyerje të plotë.....14 – 16 m<sup>2</sup>/L
- Koha e tharjes.....4 – 6 orë

**REZIKSHMËRIA:** Bojrat ORALAC janë të djekshme (R10), të dëmshme po të nuhaten (R20), irritojnë lëkurën (R38) si dhe duhet të ruhen larg fëmijëve (S 2), në vënde të ajrosura mirë (S 9) dhe larg burimeve të zjarrit (S 16). Po kështu, mbeturinat e bojës nuk duhen derdhur në kanalet e shkarkimit (S 29) dhe ambalazhet e përdorura duhen hedhur në vënde të sigurta (S 35).

**AMBALAZHIMI:** Ambalazhimi bëhet në kuti metalike 0.75L dhe 3.75 L.